


Revista e shkollës” Gj . K . Skenderbeu”



Dituria



Arsimi në shkollën tonë



Shkollës jonë është një vatër e lashtë e arsimit shqip,ka qenë zhvillimi dhe përparimi pothuajse i gjithë trevave tona.Në këtë shkollë kanë dhënë kontribut shumë arsimdashës si mga vendi po ashtu edhe nga Shqipëria.

Përparimi i madh është arritur me zhvillimin dhe lulizimin të pashembullt të arsimit dhe kulturës së popullit tone,ku ky arsimim reflektohet sot në ditët tona .Kjo shkollë ka një zhvillim të hovshëm ,sepse ka pasur një gërshetin të normave të reja në arsim.

Shkolla fillore” Gjergj Kastrioti Skenderbeu”— f. Sërbicë




E d u k i m i i n x ë n ë s v e

Në ditët e sotme në vendin tonë procesi i arsimimit dhe i edukimit po shfaq një shturje nga procesi i zhvillimeve shoqërore-ekonomike brenda dhe jashtë vendit. Duke qenë të vetëdijshëm se edukimi është i pandarë nga shoqëria në të cilën ajo shoqëri zhvillohet.



Arsimimi në shkollën tonë

Misioni i shkollës sonë është të jetë e hapur për të ri, me forma dhe metoda më bashkëkohor në të cilën çdo fëmijë do të përparoj në nivelin e arsimit dhe edukimit, do t'i zhvillojë të njëjtat, do



t'i paraqes qëndrimet e tij, do të dij sa vlen, do t'i respektoj ata që vlejnë, gjithashtu duke formuar sistemin e tij të vlefshëm me ndihmën dhe angazhimin profesional të arsimtarëve dhe prindërve. Në periudhën popul-

lore do të jemi shkollë në të cilën arsimtarët, nxënësit dhe prindërit së bashku do të krijojmë të ardhmen e fëmijës së tij në mjedis të rregulluar dhe mjedis miqësor që të respektohen nevojat e të gjithëve, marrdhëniet demokratike toleruese dhe vazhdim tradicional për ndjekje dhe të hapur për ndryshim të formës (llojit) të ri në punën edukativo-arsimore. Shkollat tona do të jetë vend ku nxënësit tanë do të takohen me teknologji bashkëkohore dhe metoda interaktive ku ato do të ndikoj në motivim

dhe përparim. Tejkallim i mësimit tradicional në atë bashkëkohor dhe punë ekipore për ne nxënësit është një zhvillim për të ardhmen tonë sepse këto metoda dhe forma bashkëkohore sjellin risi dhe aktivitete për ne dhe njëkohësisht na përgadis për një arsim bashkëkohor.



Edukimi i nxënësve

Në ditët e sotme në vendin tonë procesi i arsimit dhe i edukimit po shfaq një shturje apo dis-balancë nga procesi i zhvillimeve shoqërore-ekonomike brenda dhe jashtë vendit. Duke qenë të vetëdijshëm se edukimi është i pandarë nga shoqëria në të cilën ajo shoqëri zhvillohet, atëherë ne po flasim për edukimin e përgjithshëm të shoqërisë, në të cilën janë pjesëmarrës edhe të rinjtë (nxënësit), të cilët përmes shkollimit (edukimit), arrijnë të përvetësojnë njohuri dhe vlera që na përcjellin në gjatë të jetës. Por, është e qartë se një grupi shoqëror (e në këtë rast po aludojmë në edukimin e nxënësve), nuk mund t'i jepen kurrsesi të gjitha njohuritë, apo vlerat me të cilat mund të identifikohemi si shoqëri përparimtare, sepse edukimi nuk fillon vetëm me procesin e shkollimit. Duke e ditur se “agjenda primare” të jetës sociale të individit janë: familja, shkolla, moshatarët, mediat; atëherë këtu duhet të theksojmë se edukimi i të rinjve (nxënësve) shtrihet në faza të ndryshme dhe gjithashtu përcillet nga koordinimi i mirëfilltë dhe i vazhdueshëm i

faktorëve që u përmenden më lartë. Çështjen e edukimit të të rinjëve (nxënësve) duhet trajtuar sipas rëndësisë dhe faktorëve kryesorë që e përcjellin atë, për shembull: dështimi shkollor; përshtatja e sistemit edukativo arsimor në kulturën e komunitetit shoqëror përkatës; gjuha e arsimit në procesin mësimor etj... Të fillojmë me trajtimin e parë të rëndësishëm “Dështimi shkollor”. Jemi dëshmitarë se në vendin tonë nuk po arrihet dotë një mesatare e kënaqshme apo një rezultat i mirë i nxënësve që po aftësohen për orientime profesionale të mëtutjeshme. Shtrohet pyetja: Përse të rinjtë (nxënësit) në vendin tonë dështojnë të kenë rezultate të mira dhe nuk po arrijnë aftësimin e duhur profesional dhe arsimor?

Problemi është sepse kemi një mangësi të madhe në trekëndëshin: Familja – Shkolla – Nxënësi, dhe anasjelltas!

Siç theksuam më herët, familja është një ndër shtyllat më të rëndësishme në edukimin e individit, si pjesë e pandashme e shoqërisë, por gjithashtu jemi të vetëdijshëm se me të vërtetë po punohet pak me

të rinjtë nga familjet tona. Ne nuk po u ndihmojmë atyre që së paku t'i orientojmë në rrugën e duhur dhe mos t'i lemë pa identitet dhe vlera.

Është e vërtetë që në rrethanat tona është e vështirë t'u ofrojmë kushte për t'i arsimuar, ngase jemi në një gjendje ekonomiko-sociale jo të kënaqshme, mos të them “të mjerë”, por a duhen kushte të veçanta për t'iu ndihmuar që së paku mos të ndihen të lënë pas dore? Pastaj, nuk duhet anashkaluar edhe mos koordinimin dhe përgjegjësinë e institucioneve shkollore, që për mendimin tim, ka një pa kujdesi të madhe në frymën e trajtimit sa më adekuat të nxënësve në proceset mësimore. Qëllimi i institucionit shkollor duhet të jetë që, të rinjtë (nxënësit) të ndjehen pjesa më e rëndësishme e shoqërisë, ashtu siç edhe janë, e mos të ndjehen si “udhëtarë”, që rastësisht u gjenden në “stacion të panjohur”.

Arianita Jagodini



DOKUMENTET E PARA TE GJUHES SHQIPE

Formula e pagëzimit

Dokumentet e para të shqipes së shkruar

1. Formula e Pagëzimit (1462)
2. Fjalori i Arnold Fon Harfit (1497)
3. Perikopeja e Ungjillit të Pashkës (fundi i sh.XV-fillimi sh.XVI)

1. Formula e Pagëzimit (1462)

Më i vjetri ndër këto tri dokumente është "Formula e pagëzimit" Ajo i përket vitit 1462. Është një fjali e shkurtër në mes të një shkrimi latinisht. Kryepeshkopi i Durrësit, Pal Engjëlli, mik e bashkëpunëtor i Skënderbeut (1417-1469), gjatë një vizite në dioqezën e tij gjeti shumë të meta e mangësi në punët e ushtrimit

të fesë. Për t'i shmangur ato ai lëshoi një qarkore në gjuhën latine. Kjo qarkore është lëshuar nga një kishë në Mat dhe mban datën 8 nëntor 1462. Me anë të saj, ndërmyet të tjerash, ai jepte leje që, në ato kohë luftërash kur prindërit nuk kishin mundësi t'i dërgonin fëmijët në kishë t'i pagëzonin vetë në shtëpi, duke thënë shqip në këtë ceremoni " Formulën e pagëzimit" që është: "Un të pagëzonj pr'emen't Atit e t'birin e t'shpirtit shenjt". Formula është shkruar në dialektin e veriut me shkronja latine. Gjuha e tekstit dhe vlerat e përdorimit në shqip të disa shkronjave latine kanë një afri shumë të madhe me

veprën e Buzukut, çka të bën të mendosh se shkrimi i shqipës duhet të ketë pasur një traditë me të vjetër, ku janë mbështetur te dy; edhe shkruesi i kësaj formule, edhe Buzuku. Dokumenti u zbuluar me 1915 nga historiani rumun Nikola Jorga në një nga bibliotekat e Milanos, Itali.



Pal Engjëlli

Fjalori i Arnold Fon Harfit

Me të njëjtin alfabet latin është shkruar në shekullin e XV edhe dokumenti i dytë i gjuhës shqipe: Fjalorthi i Arnold fon Harfit, i vitit 1497. Udhëtari gjerman Arnold Fon Harf (1417-1505) në vitin 1496, u nis nga Kelni, për të bërë një vizitë në tokat e shenjtja, në Palestinë, udhëtim që e kreu për tre vjet. Në vitin 1497 ai kaloi në bregdetin e Shqipërisë dhe konkretisht në Ulqin, Durrës e Sazan. Gjatë këtij udhëtimi për të komunikuar sadopak me njerëzit, ai shënoi 26 fjalë shqipë, 8 shprehje e numrat 1 deri 10 dhe 100 e 1000 të shoqëruar me përkthim në gjermanisht. Janë fjalë të zakonshme si: ujë, verë, bukë, mish etj., që iu deshën udhëtarit në jetën e tij të përditshme sa qëndroi në Shqipëri. Me përshtypjet e udhëtimit Harfi la

në gjermanisht një dorëshkrim, i cili u botua më 1860, pas tre shekujsh e gjysmë. Këtu gjendet edhe ky Fjalorthi i vogël i gjuhës shqipe, i cili përbën dokumentin e dytë të shqipes së shkruar. Udhëtari, përveç listës së fjalëve, shprehjeve e numërore, ka lënë edhe disa shënime në ato vende të bregdetit shqiptar ku kaloi. Ndër të tjera ai shkruan se "Ulqini është një qytet shqiptar i bukur e i vogël". Për Shkodrën megjithëse kaloi nëpër të, ngaqë udhëtimi Ulqin-Durrës, e bëri me det, thotë "se është një qytet i madh i sapo pushtuar nga osmanët". Ishullin e Sazanit e përshkruan "si një liman të mirë deti, ku ka shume anije, në krahun e majtë të të cilit ndodhet një fshat i madh me 2000 vatra, i quajtur Vlorë" etj.



Arnold Von Harff

Perikopeja e Ungjillit të Pashkës (fundi i sh.XV-fillimi sh.XVI)

Perikopeja e Ungjillit të Pashkës (fundi i sh.XV-fillimi sh.XVI) është dokumenti i tretë i shqipes së shkruar Ai i perket fundit të shekullit XV ose fillimit të shekullit XVI. Ky dokument përbëhet nga 2 pjesë të vogla bible në gjuhën shqipe që u gjetën në një dorëshkrim greqisht të shekullit të XIV, me të cilin ato nuk kanë asnjë lidhje. Ato janë në dialektin e Jugut, të shkruara me alfabetin grek. Këto fakte tregojnë se gjuha shqipe në atë kohë duhet të ketë qenë shkruar jo vetëm në Shqipërinë e Veriut, por edhe në Shqipërinë e Jugut. Po para këtyre tri dokumenteve a ka qenë e shkruar gjuha shqipe?

Kjo është një pyetje që deri më sot nuk ka gjetur përgjigje të plotë. Shumë të dhëna na bëjnë të mendojmë se shqipja duhet të ketë qenë shkruar edhe me parë. Ndër të tjera arqipeshkvi francez i Tivarit, i njohur me emrin Brokard, që ka shëtitur shumë vende të Evropës dhe të Azisë, në një relacion latinisht të vitit 1332 shkruante: "Sado që shqiptarët kanë një gjuhe fare të ndryshme nga gjuha latine, prapë ata kanë në përdorim edhe në tërë librat e tyre shkronjën latine". Ky fakt të bën të mendosh se shqipja duhet të ketë qenë shkruar të paktën që në shekullin XIV. Por kjo deri me sot nuk

është e dokumentuar.




Faqe nga dokumenti

...quasi Albanice. Vnde paganos premens Arce et hinc et sperne scire. Et q. si quis hoc modo baptizatus fuerit iterum non rebaptizetur sed suppleatur orationes et qd' d'ignum est Verum si dubitauerit. An verba illa prolata fuerint a laico vel femina, que forte sic baptizauerit. Ita sacerdos baptizans mittat aquam in puerum diuidendo si tu es baptizatus ego non te rebaptizo. sed si non es baptizatus ego te baptizo in nomine Patris et filij et spiritus sancti...


Item mandamus q. in qualibet Ecclesia in qua exerceatur cura animar. fiat fons usq. ad Sabbatum sanctum proxime futurum sub pena Interp. Quinq. et si erit Contrafactum totiens cadat in dictam penam. quotiens quidecim dies eodem decurrerit quousq. fons factus erit.

Cum Confirmatus Crismatis sic vni ex septē Sacramentis Ecclesie necessarium, et non nisi per Pontificem conferri potest, reperimusq. des ut plurimum non Crismatis p'rog. Ignorantia. differrentium illis Crismatis quando per presbiterum

Formula e Pagëzimit



Fjalorthi i Arnold Von Harffit



Arianita Jagodini

Historiku i Skenderbeut

Gjergj Kastrioti ishte djali më i vogël i Gjon Kastriotit dhe i princeshës Vojsava, fëmija i fundit midis katër djemëve dhe pesë vajzave. Mendohet se lindi më 6 maj 1405 në Mat. U mor peng si nizamë pas thyerjes të të atit nga Sulltan Murati më 1421 dhe u dërgua në oborrin e Sulltanit në Adrianopojë. Atje, zgjuarsia dhe shkathtësia e çuan Gjergjin në shkollën e sulltanit (içogllanëve) që përgatiste komandantë e nëpunës. Ai



nuk e harroi vendin e tij të dashur dhe priste me padurim rastin të kthehej në tokën që e lindi. Me vdekjen e të atit, ai shpresonte t'i zinte vendin, por në fakt sulltani e emëroi



sanxhakbej jashtë tokave shqiptare. Më 3 nëntor 1443 në afërsi të Nishit, u ndeshën dy ushtritë. Ushtria osmane u shpartallua dhe u tërhoq në panik. Skënderbeu filloi të zbatonte planin e kryengritjes, së bashku me 300 kalorës shqiptarë e me të nipin Hamza Kastrioti, u kthye në Dibër, ku populli e

priti si çlirimtar. Mori masa për përforcimin e rrugëve nga mund të vinin osmanët, dhe prej andej iu drejtua Krujës. Me një ferman të rremë shtiu në dorë qytetin e garnizonin dhe kështu më 28 nëntor 1443 u shpall rimëkëmbja e principatës së Kastriotëve. Mbi kështjellën e Krujës u ngrit flamuri me shkabën e zezë dykrenare i Kastriotëve.

Në janar të vitit 1468 Skënderbeu u sëmur gjatë zhvillimit të një Kuvendi të thirrur nga ai, në të cilin ishin të ftuar të gjithë princat shqiptarë. Vdiq me 17 Janar 1468 në Lezhë. I mbuluar me lavdi, ai u varros në Lezhë.

Fisnike Ipcja

Speciet në zhdukje

Prerja e drurëve

Është problem prerja dhe djegia e drurëve. Sepse nuk mund të pastrohet ajri. Njeriu është faktori kryesor që e shkaktohet këtë dëm natyrorë dhe do të vijë deri në shkatërrim e natyrës.

Është e ndaluar prerja e drurëve sepse prish pamjen e natyrës, nuk do të kemi ajr të pastër dhe do të prishen shumë shtëpi të ksfshëve.



Martë Mërkurë Enjte

18/-1 0/-2 40/-10



Arritja deri në zhdukje

Rinocerontët janë një specie në zhdukje, për shkak të gjuetisë së madhe.

Rinocerontet janë të preferuar për shkak të bririt të tyre dhe shumë persona gjuajnë Rinoceront.



Lajme i çuditshëm!!!!

Pinguinët kanë filluar të futurojnë!



Mirlinda Arslani

TRURI I NJERIUT

Truri tek njeriu është pjesa e trupit që gjendet në kokë i mbrojtur nga kafa dhe cipa trunore dhe që shërben për kapjen, përpunimin dhe ruajtjen e njoftimeve të marra (në një nivel të lartë), nëpërmjet organeve shqisore (syve, veshëve, etj.), për t'i shndërruar në lëvizje që janë mjeti i ndërveprimit me mjedisin e jashtëm. Truri është qendra e kontrollit të sistemit nervor qendror.. Truri është një organ tejet i ndërlikuar. Truri i njeriut, p.sh. përbëhet nga më shumë se 100 miliardë neurone, secili i lidhur me mëse 10.000 të tjerë.



Truri ndahet në:

1. Truri i madh
2. Ndërmjet truri
3. Trungu trunor
4. Truri i vogël



Truri i madh – Kora e trurit të madh është e përbërë prej disa milionave qeliza që kanë rol dhe funksion të rëndësishëm.

Sipërfaqja e trurit të madh është 2200cm³. funksioni i tij është të udhëheqë me punën e organeve. Te truri i madh gjendet qendra për të mbajtur mend (shkrim, lexim, të folurit etj).


Ndërmjet truri - Në pjesën e poshtme të tij gjendet hipofiza e lidhur me hipotalamusin si qendër kontrolluese e metabolismit, temperaturës së trupit, procesin e gjumit dhe funksione të tjera, ndërsa në pjesën e sipërme epifiza si gjëndër me tajim.

Truri i vogël – gjendet nga ana e përparme nën ashtin e zverkut. Ai është qendër e drejtpeshimit, lëvizjes dhe koordimit të punës së muskujve.

Trungu trunor – pjesa e zgjeruar e palcës kurrizore quhet ARÇ ose Trung trunor, pëndryshe mund të quhet nyja e jetës sepse bënë rregullimin e punës të zemes dhe të frymëmarrjes ka edhe qendra tjera refleksive si gëlltitja, kollitja, teshtitja etj.

Tumori i trurit - është një sëmundje e rëndë në sistemin nervor të njeriut.

Kanceri i trurit paraqet një shumim të pakontrolluar të indit të trurit si dhe cipave që rrethojnë trurin. Në të shumtën e rasteve ata zhvillohen nga indi lidhor nervor (glia dhe astrocite), por shpesh edhe nga cipat e trurit, ose janë metastaza nga tumore të tjera të trupit.



Simptomat

Varësisht nga shkalla e zhvillimit simptomat e tumorit të trurit janë të shumta e të shumanshme dhe mund të ndahen në mënyrë të thjeshtësuar në tre grupe:

- Shenja fokale neurologjike varësisht nga lokacioni (si mpirje të njëanshme të trupit dhe humbje të pjesshme të shikimit),
- Epilepsi të ndryshme dhe

pasojat e rritjes së shtypjes së trurit si: vjellja, të marruarit e mendve, etj.



Simptoma të tjera të pacaktuara, të cilat nuk janë aq tipike vetëm për tumore: dhimbjet e kokës, lodhja, humbja e peshës.

Pasi që tumori vetëm në një masë të vogël mund të shumohet në pjesën e ashtit të kafkës, pasi që kafa nuk mund të bymehet, tumori fillon varësisht nga shumimi i tij të ndrydhë trurin. Për këtë shkak edhe tumori i mirë, nëse nuk shërohet me kohë mund të sjellë vdekjen e njeriut.

Fisnike Ipcja

Duhani sëmundje e rëndë




Duhani ka ekzistuar prej kohësh, vazhdon të ekzistojë edhe pse njerëzit nuk mbushen me



mend se çfarë dëmsh shkakton, e përdorin si dënim për jeten, veten e tyre...ka edhe shumë shkaqe të tjera se pse nuk duhet ta përdorim du-

hanin. Ja disa pyetje për ata që e pinë duhanin: Pse a është pa tjetër që ti ta përdorësh duhanin? Si e konsideron ti duhanin ne jetën tënde? Pse njerëzit e konsumojnë duhanin?. Këto janë disa pyetje shumë të lehta, por shumë të rënda për tu përgjigjur. Unë do të thosha se njerëzit më të dëmtuar nga duhani janë rinia Pse rinia? Sepse ata e nisin duhanin si një argetim, por perfundojnë në një gjendje shumë të vështirë, ata duhanin e nisin që në shkollë fillore

ose në bangat shkollore, ata fare nuk mendojnë për pasojat që do tu ndodhin ata mendojnë se po bëjnë një gjë të mirë me një fjalë ata ndihen krenar në atë moment se çka po pine... Me kaqë po i jap një perfundim, duke ju thënë atyre që e pinë duhanin se si ata vetë e kanë filluar duhanin dhe të vinë në perfundim a është një krenari të pish duhan, apo është diçka shumë më e keqe se sa një krenari ku vetë me vetëdije vret vetëveten.



Ilirida Ballazhi

Sëmundjet e kohës, droga dhe alkooli



Droga: varësia e drogës ose pirja e tepruar apo varësia e drogës është një sëmundje që përfshin varësia kimike të cilat ndikojnë në sistemin nervor qendror dhe funksionet e trurit. Droga shkakton ndryshime në sjellje, perceptimi, në gjykim dhe për emocionet. Efektet e drogës ndryshojnë shumë, varësisht nga lloji i drogës dhe shumës ose frekuenca me të cilën ata konsumojnë. Mund të intensifikohet apo të shurdhër e shqisave ose shkaktoj ndjenja të eufori apo dëshpërim. Nevojat e konsumatorit për të konsumuar disa substanca që të arrihet

ndjenja të caktuara të pëlqyeshëm ose për të hequr ndjenjat e pakëndshme që rezultojnë nga heqja e substancës . Duhani dhe alkooli :

Kudo që të shkojmë, kudo që të jemi duhani është bërë prezent, dhe i pranishëm në shoqërinë tonë, një shok i keq i bezdisshëm, por mbi të gjitha i rrezikshëm. Jo rrallë ndodh me ato që shkojnë në punë, ta fillojnë ditën me kafe, cigare dhe një teke apo dopio pijesh alkoolike . Njerëz të punsuar, apo jo, të vjetër ose të rinj mbushin lokalet ndërkohë që duhani është shoqëruesi i përhershëm, dhe në të shumtën e rasteve edhe alkooli, ku pija

e preferuar është sipas thellësisë së xhepit, si: raki, konjak, kampari ose uiski. Dhe ç'është më e keqja deri dje, këto dy vese ishin përgjithësisht pronë e meshkujve, por që pas viteve të '90, përdorimi i alkoolit dhe duhanit nga femrat filloi të rritej në mënyrë të frikëshme, sa sot në vendin tonë, ashtu edhe në botë statistikat flasin për një barazim të përdorimit midis dy gjinive. Po t'i pyesësh njerëzit për dëmet që sjellin këto dy vese (pirja e duhanit dhe alkoolit), në përgjithësi ato të përgjigjen, se i dinë dëmet, por prapë vazhdojnë të pijnë duhan edhe alkool.

Drita Limani


EXCALIBUR – THE MAGIC SWORD

A long time ago, so the story goes, a young boy called Arthur became the King of England after he pulled a sword out of a stone.

The sword was Excalibur. It had a lot of power. The Lady of the Lake gave it to King Uther but asked him to give her his first born child. Uther became powerful. When his first child was born, Merlin the magician came to take the baby. Uther tried to stop him but thieves attacked him. Before he died, he put Excalibur into a stone and asked Merlin to make his son a king. Merlin promised that only someone with a pure heart could pull it out and become the next King of England. When Arthur pulled the sword out, people were surprised. Merlin explained that Arthur was Uther's son and the people were happy. Arthur was a good king. He built a big castle, Camelot, and ruled over England with his knights. He called them the Knights of the Round Table. Together they made England a strong country.



Excalibur



CAMELOT

Arianita Jagodini

BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

Deutschland ist ein demokratischer parlamentarischer Bundesstaat seit 1949. Hauptstadt von Deutschland ist Berlin mit 3,4 Millionen Einwohner. Die Staatsflagge besteht aus drei horizontale Streifen in Schwarz, Rot und Gelb. Die deutsche Nationalhymne besteht seit 1991 ausschließlich aus der dritten Strophe des Deutschlandliedes von August Heinrich Hoffmann von Fallersleben. Die Melodie stammt aus der früheren Kaiserhymne von Joseph Haydn. 3 Oktober ist Deutschlands Nationalfeiertag, Tag der Deutschen Einheit. Die Amtssprache in Deutschland ist Deutsch. Für 100 Millionen Menschen ist Deutsch Muttersprache.



BUNDESWAPPEN

GEOGRAFIE



BUNDESFLAGGE

Die Oberfläche von Deutschland ist 357 021 qkm. Küste von Deutschland hat eine Fläche von 2389 km. Deutschland liegt im Herzen Europas und ist von neun Nachbarstaaten umgeben: Frankreich, Schweiz, Österreich, Tschechien, Polen, Dänemark, Niederlande, Belgien und Luxemburg.

Der höchste Berg ist die Zugspitze 2963 m. Die längste Flüsse sind Rhein 865 km, Elbe 700 km, Donau 686 km. Deutschland ist ein Bundesstaat aus 16 Ländern, die jeweils eigenständige, wenn auch eingeschränkte Staatsgewalt besitzen. Die größten Städte in Deutschland sind: Berlin, Hamburg, München, Köln und Frankfurt.

**Ermira
Ballazhi**

Liberté

Sur mes cahiers d'écolier

**Sur mon pupitre et les ar-
bres**

Sur le sable et la neige

Sur toutes les pages lues

**Sur toutes les pages
blanches**

Sur la santé revenue

**Pierre sang papier ou
cendre**

Sur le risqué disparu

**Sur l'espoir sans souve-
nir**

Et par le pouvoir d'un nom

J'écris ton nom

Je recommence à vivre



***Je suis né pour te con-
naître***

Pour te nommer

Besart Lutfiu

Ultrazëri dhe zbatimi i tij

Valë e zëshme me frekuencë më të vogël se 16Hz quhet infrazë, ndërsa me frekuencë më të madhe se 20000 Hz quhet ultrazë.



Karakteristikat e komunikimit nëpërmjet ultrazërit quhet ekolokacion.




$$S = 2h \text{ ose } s = v \cdot t$$


$$2h = v \cdot t \Rightarrow h = \frac{v \cdot t}{2} = \frac{1500 \frac{m}{s} \cdot 4}{2} = 3000m$$

Metoda më e shpejtë që na mundëson të shohim situatat në organet e brendshme pa intervim kirurgjik quhet ehografi.

Arianita Jagodini



EDUKATA



Edukata është një veprimtari që fillon në familje qysh me lindjen e fëmijut dhe vazhdon gjatë gjithë jetës së tij. Pas edukimit që merret në familje ajo vazhdon me edukimin parashkollor, edukimin që merrë në shkollë fillore dhe të mesme, pastaj vazhdon edukimi univerzitar dhe posuniverzitar. Çdo veprimtari që ushtrohet mbi fëmijën është një lloj edukimi për të sepse me edukim ai ndryshon mendimin, sjelljen, personalitetin dhe karakterin e tij. Gjatë punës mësimore në shkollë neve mësojmë si

të veprojmë, si të punojmë dhe si të sillemi me njerëzit. Edukohemi në aspektin fizikë, psiqik dhe moral. Kështu nga çdo këshillë e arsimitarit, nga çdo përmbajtje mësimore tek ne nxënësit zhvillohen vetitë e mira, shprehitë për punë, kultura, sjellja, besnikëria, toleranca, qëndrimi i drejtë (të gjykojmë të mirën dhe të keqen). Pra, me një fjalë mund të themi se mësimi në shkollë ushtron edukim edukativ tek nxënësit. Çdo vit shkollor marrim dituri të reja, paisemi me cilësi më të mira të cilat neve nga çdo përparim na ngjallin përjetime, emocione, vetëbesim, jemi më të pavarur në punë, mund të paragjykojmë, të sjellim vendime dhe ta shohim vetëveten të barabart në punë, t'i krahasojmë

njohurit tona me njohuritë e të tjerëve dhe njëkohësisht të ndjejmë kënaqsin nga të arriturat tona. Me një fjalë nga çdo njësi mësimore, nga çdo fjalë apo këshillë e arsimitarit, nga çdo dituri që marrim në shkollë neve përfitojmë vlerat pozitive që do të thotë, të mos gabojmë gjatë bisedave, të jemi të sjellshëm ndaj shokëve, familjes, arsimatrëve, më të vjetërve dhe ta çmojmë çdo gjë që është në të mirën e njeriut, e gjithë kjo është njeriu.

Ermira Ballazhi



Aktivitet shkollorë

Festat shkollorë çdo fëmijë i pret me plotë gëzim sepse në ato momente ndjejnë një kënaqësi të veçantë artistike. Këto programe festive gjatë këtij viti shkollor e përgatiten me arsimtaret e gjuhës shqipe dhe me arsimtaren e pallodhur të arsimit muzikor. Ne programet shkollorë organizoheshin aktrime të ndryshme si:



drama, humore, recital, poezi fëmijësh, komedi të ndryshme, valle etj. Çdo gjë përgatitet në mënyrë profesionale për çdo festë, kemi organizime të ndryshme dhe me plotë skenare të reja. Do të

veçoja dramën "Plaku dhe plaka" ku trajton një temë për vuajtjet e popullit shqiptarë dhe mërgimtarëve jashtë atdheut. Këto programe gjatë këtij viti shkollor si udhëheqëse ishin Arinuta Jagodini dhe Shasime Lazami. Në program si shikues merrnin pjesë si: kryetari i komunës së Osllomes, poashtu nuk mungonte edhe prezenca e arsimtarëve dhe prindërve. Për organizimin e këtyre programe nxënësit arrinin sukaes të mire, por gjithashtu nevojiteshte edhe ndihma e arsim-

tarëve të cilët na ushtronin për çdo hap që të dalë sa më bukur në skenë. Dramat shfaqeshin në skenë aq sa kemi kushte në këtë shkollë. Recitonim poezi, që ishin të veçanta për çdo festë. Vallzimet

bëheshin në mënyrë të përsosur profesionale edhe vajzat jepin poashtu mundin e tyre, por gjithmonë veshjen e kishin me teshë kombëtare. Në skenë pas çdo prezantimi të nxënësve poastu nuk mungonin duartrokitjet dhe buseqeshjet nga publiku, kjo është shumë e vaçant dhe të jep kuraj për sukses të tjera. Pra, kjo është ajo që kemi përgaditur për të shfaqur sa më mirë aktivitetet tonë, kjo shkollë gjithmonë ka përgatitur nxënës me talent që kanë pasur sukses edhe në shollën e mesme, ju priftë e mbara talentave të rinjë.

Shasime Lazami



EKO SHKOLLA

Prodhimi i energjisë elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike bëhet me një proces teknologjik sa të gjatë, aq edhe të vështirë.

Ajo prodhohet në disa mënyra si me:

- 1.Hidrocentrale
- 2.Termocentrale
- 3.Centrale atomike(nukleare)
- 4.Centrale e erës(eolike)
- 5.Centrale solare(diellore)
- 6.Agregatë të ndryshëm

Prodhimi i rrymës elektrike në



Hidrocentrale:

Për tu prodhuar rryma elektrike në hidrocentrale është e nevojshme që të ketë ujë të mjaftueshëm, i cili mblidhet dhe pengohet me pendë.

Mbas pendës vendoset turbinë e cila ka boshtin dhe lopatat.

Në lopatë bie uji me një shpejtësi të cilat e vëjnë në lëvizje boshtin e turbines, i cili llogaritet si rotor.

Në dalje është gjeneratori i rrymës elektrike ku është i vendosur statori.

Kur rotori lëvizë aty krijohet fushë elektromagnetike e cila shëndrrohet në rrymë elektrike drejtvizore e cila pastaj nëpërmjet transformatorit shëndrrohet në rrymë alternative. Hidrocentrale të këtilla ka disa në Maqedoni, por më i madh dhe më i sofistikuar është ai në "Kozjak" me kapacitet 80MW/h dhe kyçet në rrjet të sistemit për 30sek.

Prodhimi i rrymës elektrike në Termocentrale

Bëhet me proces më të gjatë teknologjik, pasi këta si lëndë djegëse përdorin qymyrin dhe mazutin.

Në Maqedoni ka dy Termocentrale që përdorin lëndë djegëse

qymyrin dhe atë: Termocentrali i "Manastirit" me kapacitet prej 660MW/h dhe Termocentrali i "Oslomesë" me kapacitet prej 125MW/h, kurse Termocentrali që përdorë vetëm mazut është ai në "Negotinë" me kapacitet prej 190MW/h. Për të fituar lëndë djegëse-qymyri është e nevojshme që të ketë rezerva të tij në të cilën pastaj vendosen makinat xehtare(eskavatorët) dhe transportuesit me anë të cilëve bëhet në fillim gërmimi i dheut deri më 40m thellësi dhe pastaj vjen gërmimi i qymyrit, i cili nëpërmjet transportuesve transportohet deri në deponinë e termocentralit, por paraprakisht i bluar deri më 3mm.



Ky në fillim ndizet me mazut pastaj digjet vetë duke u tërhequr nëpërmjet ventilatorëve. Kjo lëndë djegëse përdoret për të bërë nxemjen e ujit në kaladajë me një temperaturë të lartë, ku shëndrrohet në avull. Uji merrret nga ujësjellësi dhe pastaj bëhet përgaditja kimike e tij (destilimi). Uji i përgaditur nëpërmjet pompave thithëse shkon në rezervarin ku nxehet deri në 250°C, prej aty kalon në tej nxehtësinë, të thatë te cili avullit ia rrisin temperaturë në 540°C dhe e thajnë. Këtu ka presion prej 120 Atmosfera. Ky avull me këtë temperaturë dhe presion nëpërmjet dizave të llavallit hy në turbinën treshkallëshe ku janë të vendosura lopatat në një kënd $\theta=17^\circ$, këto



bëjnë lëvizjen e boshtit të turbinës i cili peshon 12T.

Këtu është vendosur gjeneratori i rrymës elektrike që përbëhet nga rotori-boshti i tur-

binës dhe statori ku krijohet fushë magnetike dhe pastaj fitohet rrymë elektrike. Këtu gjithmonë në komandë duhet ruajtur temperatura 540°C dhe shtypjen prej 120 Atmosfera, me qëllim që boshti i turbinës të ketë 3000 rrotullime në minutë dhe frekuencë prej 50Herc. Avulli prej lopatave të turbinës kalon në kondensatorët ku kondensohet (shëndrrohet) në ujë dhe pastaj ai qarkullon në kaladajë. Këto central si lëndë djegëse për fitimin e avullit përdorin atomin edhe atë uranin U235 me 7% dhe U238 për zbutje me 93%. Paraprakisht përgatitet një bazen me murë të trashë të betonit kualitativ edhe atë me thellësi prej 5m dhe trashësi 5m, ku është futur reaktori. 1kg U235 lëshon energji sa 30000T qymyr në kualitet prej 3200kJ/kCAL.. Në reaktor për mos me ardhë deri te eksplozimi vendoset pllakë grafiti dhe shtohet 93% U238.

Pastaj fitimi i rrymës elektrike është i njëjtë si te termocentralet.

Shlaka e mbetur futet në enë speciale dhe fundoset në thellësi të detit me qëllim të mos ketë radioaktivitet.

Prodhimi i energjisë elektrike



në Centralet eolike(të erës):

Këto prodhojnë pak rrymë elektrike të cilat në një numër pak më të madh vendosen në një lartësi shumë të madhe ku ka erë, e cila i vë në lëvizje ventilatorët.

Prodhimi i rrymës elektrike në Centralet solarë(diellore):

Kohës së fundit si teknologji më e avansuar dhe më ekologjike njihet prodhimi i energjisë elektrike solare. Këtu si burim kryesor për nxemjen e ujit përdoren solenoidët të cilët nxe-



hen nga rrezet e diellit.


Shfrytëzimi i rrymës elektrike

Energjia elektrike gjen një zbatim të madh në jetën e përditëshme pa të cilën nuk mund të paramendohet jeta. Zbatohet në optikë, akustikë ,termikë ,industri, elektronikë, elektoteknokë, mjekësi, buqësi, ekonomi, transport etj. Ajo përdoret për ndriçim, dhe në amvisri të shumë aparate ekektrike,si p.sh. te frigoriferi, te shporeti elektrik,bojleri, hekuri për hekurosje, lavatriçja, kaloriferi,

fshesa elektrike, mikrovelja, televizori, kompjuteri, CD-pleyeri etj. Ajo ka për detyrë të vëjë në lëvizj elektromotorrë të ndryshëm dhe të bëjë ndryshime në punën dhe energjinë e tyre.



Elektromotorrë të tillë kanë të gjithë aparatet e amvisrisë, fabrikave, tranvajet, makinat e ndryshme etj.

Kursimi i rrymës elektrike

Që në fillim përmendëm se prodhimi i energjisë elektrike është proces i rëndësishëm në jetën e përditëshme sepse lëndët djegëse dita-ditës janë

duke u konsumuar, që do të thotë se rezervat janë duke u pakësuar. Prandaj, duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe sa më racional në shfrytëzimin e saj dhe të mundohemi që ta kursejmë sa më shumë. Kursimi i rrymës elektrike mund të bëhet në mënyra të ndryshme si p.sh. duke i zëvendësuar llambat e zakonshme me llamba ekonomike, të mos kyçen llambat pa nevojë, të mos lihet dera hapur nëse ngrohemi me kalorifera, mos lihet frigoriferi hapur, me restriksione të ndryshme dhe mënyra tjera që ne i shohim të arsyeshme për kursimin e rrymës elektrike.



**Besart
Lutfiu**

EKO SHKOLLA

Kursimi i energjisë elektrike

1. Ndryshoni llambat e zakonshme duke vënë llamba ekologjike. Një ndër mënyrat më të thjeshta për të zvogëluar konsumin e energjisë elektrike është të zëvendësoni llambat e zakonshme me ato ekonomike. Sepse ato ekonomiket janë 12 herë më afatgjata se ato të zakonshmet.



2. Izoloni ngrohësin e ujit. Izoloni papafingon, muret dhe cilindrin e ujit të ngrohtë. Pjesa më e madhe e energjisë elektrike konsumohet më kotë, pasi shërben për të ngrohur hapësirën. .

3. Ndryshoni ngrohësin e ujit.



Nëse keni një ngrohës uji të vjetër, atëherë me siguri ju kërkon shumë energji dhe rrjedhimisht edhe shumë para. Teknologjia sa vjen dhe përparon, duke ndikuar njëkohësisht edhe te ngrohësit e ujit, që çdo familje i ka. .

4. Ricikloni. Tani që kjo metodë është e njohur nga




të gjithë, mos hezitoni të ndani shishet plastike, shishet e qelqit, kanaçet, letrat apo gazetatat dhe

materialet e tjera të konsumit tuaj të përditshëm nga njëra-tjetra.

5. Doppio xham për dritaret. Xhamat e zakonshme të dritareve



dhe kornizat e paizoluara lëshojnë një të pestën e nxehtësisë apo të ajrit të ftohtë jashtë.



Arianita J.

Fjale te urta

- Dy shaka bëjnë një të vërtetë.
- Çdo mësim e ke fitim, çdo pësim është mësim.
- Bukuria pa dituri, si dru e thatë pa stoli.
- I varfëri mbjell, i pasuri ha.
- Dita pa punë ,nata pa gjumë.
- Dora me baltë ,buka me mjaltë.
- Armiku më i rrezikshëm është, ai që harrohet.
- Trimëria dhe liria janë si nanë e bijë.
- Rrushit varet në degët e vet.
- Më mirë gomar, po tëndin, se kalë, po të botës.
- Më mirë të vdesësh duke luftuar, sesa të rrosh i turpëruar.
- Mjer ai që pret nga tjetri!
- Mos u ban mjaltë, se të han mizat.
- Burri s'matet me pëllëmbë ,po me zemër.
- Mos prit nga ai që trembet nga hija e tij.
- Fol pa sulmuar, dëgjo pa u mbrojtur.

Ilir Asani



Njeriu dhe gjarpri

Na ishte një herë një burrë çysh shkoj në mol për dru pëqe pa një gjarper ene i tha : eja tët pështy ke goja ene domonesh të morrish vesht çysh bojnë llaf kafshet. Aj tha : Kom freyk mos me çukish . Gjarpri ja kthej : Jo mo ski freyk se nuk të çuk ene burri u pajtau.

Një ditë tu mel dhent ouku u tha këlyshve do shkoj te morrë dele ene për mau ene për ju ama kta i nejni ene burri ene i maurr vesht dhe i shpëtoi delet.

Një ditë burri shkoj prap në mol ene e xhet gjarprin. Gjarpri i tha : mos i dëfto askujt për këtë xhoa se do të vdesish. Burri në mromt u kthey ke shpeja en era të fliej. Në mxhest va vau samoret kolve ene shkoj në mol me grun e vete, burri i hypi mshkullit kurse gruaja e tij femrës.

Mashkurri i tha femrës haj të torremi kush ja lije. Femra i tha une mbaj katër shpejrtna a tej vetem dy. Burri i nejni ene i nail kolt ene burri i hypi femrës a gruaja atit i hypi ene u buon tre me tre ene ja la femra. Gruaja diktoi nej sen ke burri ama nuk i tha asnjisen.

Një ditë gruaja i tha burrit tëm therish një kinxh të mejr. Burri zau një kinxh ene delja tha pese kinxha kum pas krejt me kane cof vec ne ky më ka met , tahej ne këtë duni te ma therni. Burri e lishoj ene zau një qetër. Gruaja diktoj prap një sen ke ai ene iu penejt dëftom çysh keja? Burri i tha si tët dëftoj duet të vdes. Hec të shkojmë ke vorret të boj një vorr tet deftoj ene të vdes gruaja u pajtau. Burri boni një vorr sa për grun ene i ra në krey ene vdiç gruaja e harmoj ene kshtou shpëtoj burri ..

Zana Limani



RAM MEMORY


RAM (random access memory) është memoria e përkohshme e kompjuterit. Kjo lloj memorie pasqyron trurin e vogël të njeriut dhe mban të dhëna për një kohë të shkurtër. Pra, memoria qendrore është vendi ku ekzekutohen të gjitha instruksionet e programeve te

ndryshme që gjenden në procesor. Dihet që të gjitha këto informacione memorizohen në formë bit-esh, pasi është më e thjeshtë paraqitja e këtyre informacioneve logjike në diçka fizike siç është hardueri.



Ne bazë të prodhimit të tyre RAM memoriet ndahen në këto kategori:

- DRAM -
- VRAM -
- SRAM -
- SDRAM -
- SIMM -
- DIMM -
- ECC -



Sporti në shkollën tonë

Sporti në simum dhe me disa ale në Gostivarë, ku shkollën nxënës të talentur atje luajtën shumë "Gj.K.Skënderbeu" në këtë aspekt kanë mire, por pak fati nuk është pak sa i zhvilluar, mbrenda kushteve që posedojnë. garuar në gara, ku në u ndihmoi, megjithëse Kërçovë kanë marrë ata marrën atë që vendin e parë. merituan dhe u rradhitën në vendin e dytë. Kjo punë ka qenë një sukses dhe kontribut i madh për lëminë e futbollit në këtë shkollë.

Një ndër sportet më të popullarizuara është futbollit. Me dy profesorë të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në mak-

Pastaj, puna e tyre dhe vullneti u shtua akoma edhe më shumë ku me shumë ushtrime, shkuan edhe në garat regjion-



Besart Lutfiu

Fjalëkryqi

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
1													
2													
3													
4													
5													
6													
7													
8													
9													
10													
11													
12													
13													

HORIZONTALISHT

1. Pjesë e gjeometrisë që studion figurat dhe trupat gjeometrikë në hapsirë
2. Krijues apo hartues i një vepre letrare,shkencore etj, - gojëtari.
3. Ton, - përzierje e disa metaleve të shkrira në zhivë - Autotarga për Shqipërinë -
4. simbol i Kalciumit - shtypi i bashkuar ndërkombëtar (anglisht)
5. Notë muzikore - inicialet e matematikanit Abel - lloj shale prej druri - Reomir.
6. Famë - makinë ushtarake e blinduar - lum në Afrikë.
7. Shko - emri i regjisores Grabocka - që ka të bëjë me bimët ;i bimëve.
8. Mjet për udhëtim e transport -kllapi,përcartje - numri 3.14
9. Dy zanore - qytet në Maqedoni (shq.) - sulm.
10. Vend i fshahtë për të sulmuar në befasi dikë - lëndë e qelqtë për të lyer enët që të marrin shkëlqim - simboli i Tantalit.

11. Spanja - makinë që punon me lëndë djegëse ,energji elektrike e që vë në lëvizje aparate të ndryshme - simbol i karbonit - gazetë turke që botohet në Prishtinë.
12. Nuk e lë të ndizet - azoti - gjykatës në kohën e sundimit osman -një zanore.
13. Qytet i filmit në Francë - mbiemri i matematikanit dhe filozofit francez Rene - kalë shale.

VERTIKALISHT

1. Planet i sistemit diellor - peshkop katolik.
2. Simboli për Ton dhe Uran - pajisje në të cilën bëhet një reaksion kimik për të prodhuar dicka - pasthirmë që përdoret kur habitemi shumë për dicka jo të zakonshme.
3. Gaz kimik pa ngjyrë - metri - Reomir - simbol i fesë myslimane, besim.
4. Vepër e gjinisë letrare ku përshkruhen ngjarje të ndryshme - dëgjoj me vëmendje, ruaj me kujdes e zgjuarsi.
5. Fryma -përpjekje për të vrrar një njeri - Gjermania.
6. Oksigjeni- autoshenja për Librazhdin - metal i çmuar/pa sh./ -intensiteti- numri një (anglisht original).
7. Shenja për metër, oksigjen, gram - qitës i aftë, që shtie me përpikmëri të madhe - simbol i kaliumit.
8. Që e ka shumë të zhvilluar shqisën e të nuhaturit - shenja për elektron, intenzitet dhe metër - autoshenja për Karlovacin.
9. Aq sa duhet, as më shumë e as më pak - autoshenja për Beratit - të ftoftë i madh, i thatë e me ngricë.
10. Radiotelevizioni; amper (shkurt) - kafsha (lat.) data (shkurt).
11. Dy zanore - emër mashkulli - Ton - përemër vetor.
12. Zezak (njeri shumë i zheshkët) - vegël dore që përdoret për punë të ndryshme - Austria.
13. Paraardhësit tanë - mashkulli i rosës (shumës).

Pak humor!!!




Një i ri i tha Sofokliut:

- Unë në 3 ditë shkruaj 300 vargje!
- Ndoshta! - ia priti Sofokliu— por ato nuk jetojnë as 3 orë, kurse unë në 3 ditë shkruaj 3 vargje, që dua të jetojnë nëpër shekuj.

Kur shkencëtari i famshëm Albert Anjshtajni shkoi, i perndjekur nga Hitleri, ne SHBA, ishte i veshur keq.

- Nuk prish punë—thoshte Anjshtajni miqëve, këtu në Amerikë nuk më njeh njeri. Kur Anjshtajni u bë i famshëm dhe nuk vishej më mirë, u thoshte përsëri:

- Nuk prish punë. Tani më njohin që të gjithë.



Lokacioni dhe kontakti

SH. F. "GJ. K. SKENDERBEU"

Sërbicë

Komuna e Oslomesë

6254 Kerçovë

Tel: +389 45 258 821

Fax: +389 45 258 821



Udhëheqse e revistës:

- **Prof. Bukuriye Ibrahim**

Perpiluan revistën:

- **Nxënësit e klasës së VIII**

Dizajnoi dhe redaktoi revistën:

- **Arianita Jagodini**